



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

BORDI DREJTUES

Nr. 153 / Prot.
12

Tiranë, më 04.07.2022

V E N D I M

Nr. 7, datë 04.07.2022

Bazuar në ligjin nr. 17/2018 "Për statistikën zyrtare", neni 20, shkronja ë), me propozimin e drejtorit të Drejtorisë së Koordinimit dhe Çështjeve Ligjore, Bordi Drejtues i Institutit të Statistikave në mbledhjen e datës 30.06.2022

VENDOSI:

Në Rregulloren e Brendshme të INSTAT-it 2019 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në nenin 3 të Kreut II, fjalët "Manuali i përshkrimeve të punës" zëvendësohen me fjalët "përshkrimet e punës" dhe fjala "të miratuar" zëvendësohet me fjalën "të miratuara". ✓

2. Në nenin 5 të Kreut II bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) në pikën 5.2 të Kreut II, fjalia "Në fund të procedurës së angazhimit të auditimit të brendshëm, drejtori i drejtorisë së përgjithshme të njësisë që auditohet miraton planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, jo më vonë se 20 ditë pune pas marrjes në dijeni të raportit final." shfuqizohet.

b) në pikën 5.2.1.3 të Kreut II, paragrafi i parë dhe i dytë ndryshohen me përmbajtjen si vijon:

"Drejtoria e Statistikave Ekonomike është drejtoria përgjegjëse për prodhimin e statistikave zyrtare mbi treguesit e ndërmarrjeve dhe statistikën sektoriale.

Misioni i Drejtorisë së Statistikave Ekonomike është të përcaktojë, hartojë, përpunojë dhe publikojë të gjithë treguesit statistikorë të ndërmarrjeve dhe statistikave sektoriale të miratuara në Programin e Statistikave Zyrtare dhe në planin vjetor të punës të Institutit të Statistikave. Ajo duhet të prodhojë statistika asnjansë, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve mbi proceset e ecurisë, zhvillimit dhe të transformimit të ndërmarrjeve ekonomike në vend."

c) në pikën 5.2.1.5 të Kreut II, në fund të pikës 1 shtohet fjala "bimor";

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta", Nd. 35, H. 1, Njesia Administrative N. 2, Tirana, Shqipëri
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300
www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

ç) në pikën 5.2.4 të Kreut II, fjalët “Programi i Statistikave Zyrtare 2017-2021” zëvendësohen me fjalët “Programit të Statistikave Zyrtare”;

d) në pikën 5.2.5 të Kreut II, në paragrafin “Qëllimi i përgjithshëm”, pas fjalëve “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” shtohen fjalët “dhe në standardet e IIA të miratuara nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë”;

dh) në pikën 5.2.6 të Kreut II, pas paragrafit të parë shtohet paragrafi më këtë përmbajtje:

“Në bashkëpunim me pikat e kontaktit, Sektori koordinon dhe monitoron punën në zbatim të angazhimit të Agjendës 2030 për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Sektori koordinon punën për indikatorët statistikorë dhe zbatimin e axhendës në kuadër të prodhimit të statistikave në nivel ndërkombëtar, qëndror dhe lokal.”.

3. Në nenin 7 shkonja “a” të Kreut III, pas fjalëve “Sekretar i Përgjithshëm” shtohen fjalët “dhe drejtorët e drejtorive të përgjithshme” dhe, në pikën 1, pas fjalëve “të anëtarëve të TND-së”, i ndryshuar dhe” shtohen fjalët “VKM Nr. 242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” i ndryshuar”.

4. Në Nenin 8 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pika 1 ndryshon me këtë përmbajtje:

“1. Lirimi dhe largimi nga detyra i punonjësve me status nëpunësi civil rregullohet sipas legjislacionit për nëpunësin civil.”

b) pikat 2 dhe 3 shfuqizohen.

5. Në nenin 9 të Kreut III bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) pika 1 ndryshon me këtë përmbajtje:

“1. Punonjësit e INSTAT-it duhet të kryejnë me profesionalizëm, me ndershmëri, me paanshmëri, me efikasitet dhe pa diskriminim detyrat e tyre në shërbimin civil, duke ruajtur dhe rritur besimin e publikut. Ata duhet të respektojnë Kushtetutën dhe të mbrojnë të drejtat dhe liritë e njeriut, si dhe t'i shërbejnë interesit publik në përputhje me ligjin. Punonjësit e INSTAT-it duhet të zbatojnë me përpikëri ligjet, politikat e përgjithshme shtetërore, vendimet dhe udhëzimet e Këshillit të Ministrave që lidhen me punën e tyre, rregulloret dhe urdhrat e brendshëm të INSTAT-it, si dhe të veprojnë në mbrojtje të interesit publik.”.

b) pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta”, Nd. 35, H. 1, Njesia Administrative N. 2, Tirana, Shqipëri
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300
www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

“1/1. Punonjësit e INSTAT-it i ushtrojnë detyrat funksionale, duke garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe trajtim të barabartë përpara ligjit, në përputhje me legjislacionin në fuqi”;

c) pika 3 ndryshon me këtë përmbajtje:

“3. Sjellja personale e punonjësve duhet të jetë e tillë që të reflektojë ndershmëri, të promovojë vlerat dhe parimet më të larta etiko-morale dhe të inkurajojë punonjësit e tjerë të veprojnë në përputhje me këto vlera.”

ç) pika 6 ndryshon me këtë përmbajtje:

“6. Punonjësit e INSTAT-it duhet që, gjatë orarit zyrtar të punës, të paraqiten me veshje serioze dhe të denjë për etikën zyrtare të qëndrimit në administratën publike. Veshja duhet të përmbushë standardet e profesionalizmit dhe modestisë, duke shmangur kështu krijimin e përshtypjes së pahijshme dhe dëmtimin e imazhit të institucionit. Ardhja në punë me shapka, kanotierë, minifunde apo pantallona të shkurtër përbën shkelje të rregullave të etikës”.

d) pas pikës 7 shtohet pika 7/1 me këtë përmbajtje:

“7/1. Eprori direkt për sjellje, veprime apo mosveprime të nëpunësit, nëse mendon se vijnë në kundërshtim me rregullat e etikës mund të kërkojë këshillim nga Struktura Mbikëqyrëse e Etikës.”

dh) në fund të pikës 8, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Ai ka detyrimin ta zbatojë urdhërin me shkrim, me përjashtim të rastit kur zbatimi i tij përbën vepër penale.”

e) në pikën 11, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Në varësi të pozicionit të punës, nëpunësi civil mund të jetë anëtar i partive politike apo i grupimeve me karakter politik, për aq sa lejohet me ligj. Nëpunësi civil lejohet të marrë pjesë në grumbullime, takime, mbledhje, tubime me karakter politik apo të shprehë publikisht bindjet apo preferencat politike, për aq sa nuk bie ndesh me legjislacionin në fuqi. Nëpunësi i INSTAT distancohet qartazi nga çdo ndikim ose presion politik, që mund të çojë në njëanshmëri gjatë përmbushjes së detyrave.”

ë) në pikën 13, në fund të fjalisë së dytë shtohen fjalët me këtë përmbajtje:

“në përputhje me Ligjin Nr.9636, datë 6.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit” i ndryshuar”.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta”, Nd. 35, H. 1, Njesia Administrative N. 2, Tirana, Shqipëri
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300
www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

f) në fillim të pikës 16, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Përdorimi i telefonit celular të bëhet në përputhje me rregullat e Kodit Etik të institucionit.”

6. Në nenin 10 të Kreut III, pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Punonjësit e INSTAT mund të realizojnë veprimtarinë e tyre nëpërmjet kombinimit të punës në ambientet e institucionit dhe telepunës tërësisht apo pjesërisht për periudha të caktuara duke respektuar përcaktimet e Kodit të Punës dhe marrëveshjen e lidhur për këtë qëllim ndërmjet tij dhe titullarit /Sekretarit të Përgjithshëm. Rregullat për telepunën përcaktohen me rregullore të veçantë”.

7. Në pikën 2 të nenit 13 të Kreut III bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) në fjalinë e parë, fjalët “20 ditë kalendarike” zëvendësohen me fjalët “4 javë kalendarike” dhe fjalët “një muaj” zëvendësohen me fjalët “30 ditë kalendarike”;

b) shkronja (a) ndryshon me këtë përmbajtje:

“a) Kërkesa për të marrë lejen duhet të bëhet gjatë vitit kalendarik ose deri në fund të tremujorit të parë të vitit kalendarik pasardhës sipas një formulari tip (Aneksi 4) i cili firmoset nga kërkuuesi i lejes, konfirmohet nga përgjegjësi i sektorit, eprori direkt dhe drejtori i drejtorisë së përgjithshme, dhe miratohet nga Sekretari i Përgjithshëm. Kërkesa për leje duhet të hartohet jo më vonë se 30 ditë nga data e fillimit të lejes së zakonshme. Në rastet kur punëdhënësi nuk miraton kryerjen e pushimeve vjetore apo i punësuari nuk i merr pushimet vjetore, të plota apo të pjesshme, ai ka të drejtë t'i kryejë ato brenda tre vjetëve nga dita në të cilën i lind kjo e drejtë, duke zbatuar të njëjtën procedurë të parashikuar në pikën 2, të këtij neni.”

c) shkronja (e) ndryshon me këtë përmbajtje:

“e) Nëpunësit kanë të drejtën e pushimit të paguar edhe për rastet si:

i. Martesën e nëpunësit civil apo të punonjësit - 5 ditë;

ii. Lindjen e fëmijës për bashkëshortin/bashkëjetuesin - 3 ditë;

iii. Vdekjen e prindërve, të gjyshërve, të bashkëshortit/ bashkëjetuesit ose pasardhësve të drejtpërdrejtë - 5 ditë;

iv. Përgatitjen dhe mbrojtjen e titujve akademikë apo diplomave të studimeve të ciklit të tretë të studimeve universitare, të lidhur me punën që kryen - 5 ditë.”

8. Në fund të nenit 14 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta”, Nd. 35, H. 1, Njesia Administrative N. 2, Tirana, Shqipëri
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 228300
www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

“Për rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit të INSTAT-it, njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore merr masa për hartimin e strategjisë së zhvillimit profesional në terma 5-vjeçare, të shoqëruar me një plan vjetor trajnimi. Strategjia e Zhvillimit Profesional miratohet nga Bordi Drejtues.”.

9. Në nenin 16, pika 5 ndryshon me këtë përmbajtje:

“5. Punonjësit e INSTAT-it kanë të drejtë të kompensohen me orë pushimi, sipas kritereve dhe masës së parashikuar nga aktet ligjore e nënligjore për punën jashtë orarit.”

10. Neni 18 ndryshon me këtë përmbajtje:

“Neni 18 – Shkeljet dhe masat disiplinore

1. Për punonjësit me status të nëpunësit civil, shkeljet dhe masat disiplinore trajtohen sipas legjislacionit për nëpunësin civil.

2. Për punonjësit me kontratë sipas Kodit të Punës, masat disiplinore merren sipas dispozitave të këtij kodi, Kodit të Procedurave Administrative, Rregullores së Brendshme të INSTAT-it, akteve të lëshuara nga strukturat vendimmarrëse të INSTAT-it dhe kontratës përkatëse të punës.”

11. Neni 19 ndryshon me këtë përmbajtje:

“Neni 19 – Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore

1. Për rastin e nëpunësve civilë, masat disiplinore merren sipas dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil.

2. Për rastin e punonjësve me kontratë, masat disiplinore merren sipas legjislacionit të punës, atij për procedurat administrative dhe këtë rregullore. Akti për marrjen e masës disiplinore nënshkruhet nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it, me propozim të eprorit direkt dhe Sekretarit të Përgjithshëm.”

12. Neni 20 ndryshon me këtë përmbajtje:

“Neni 20 – Shuarja e masave disiplinore

Masat disiplinore shuhen, për shkak të ligjit, pas kalimit të afateve të parashikuara në legjislacionin për nëpunësin civil.”

13. Në nenin 21 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) në shkronjën (b) të pikës 5, fjalët “duke pasqyruar referencën e paragrafit përkatës të “Manualit të përshkrimeve të punës së stafit të INSTAT-it” shfuqizohen;

b) në pikën 7, fjalët “gjatë vitit të parë të punës” zëvendësohen me fjalët “për kohëzgjatjen mbi gjashtë muaj deri në dy vjet punë”;

c) në pikat 8 dhe 9, pas fjalëve “kontratë pune” shtohen fjalët “ose shërbimi”.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta”, Nd. 35, H. 1, Njesia Administrative N. 2, Tirana, Shqipëri
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300
www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

ç) në pikën 10, në fund të fjalisë shtohen fjalët *“dhe Udhëzimin e përbashkët për marrjen e punonjësve me kontratë të përkohshme lidhur mes INSTAT-it dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”*.

14. Në nenin 22 të Kreut III bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) pika 14 ndryshon me këtë përmbajtje:

“14. Nëse punëmarrësi nuk ka kryer një vit të plotë pune, kohëzgjatja e pushimit vjetor të paguar të tyre përcaktohet në përpjesëtim të drejtë me kohëzgjatjen e marrëdhënies financiare të punës”;

b) pikat 16 dhe 17 ndryshojnë me këtë përmbajtje:

“16. Të drejtën e përfitimit 5 (pesë) ditë pushimi të paguar në rast vdekje të bashkëshortit/bashkëjetuesit, prindërve, gjyshërve ose pasardhësve të drejtpërdrejtë të tij.

17. Të përfitojë jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike pushimi të papaguar për arsye shëndetësore apo arsye të tjera personale që lidhen me vetë nëpunësin, fëmijët, bashkëshortin/bashkëjetuesin apo prindërit.”

15. Në nenin 24 të Kreut III bëhen këto ndryshime:

a) në pikën 2, pas fjalëve *“paaftësie të përkohshme në punë”* shtohen fjalët *“nga punëdhënësi ose sigurimet shoqërore”*;

b) në pikat 4 dhe 5, fjala *“të justifikuar”* zëvendësohet me fjalët *“për shkaqe të arsyeshme”*.

16. Në nenin 25 të Kreut IV bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) pika 1 ndryshon me këtë përmbajtje:

“1. Dosjet e personelit të INSTAT-it administrohen nga Sektori i Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Financës dhe Projekteve, në përputhje me legjislacionin në fuqi për rregullat dhe administrimin e dosjeve të personelit dhe regjistrin qendror të personelit.”

b) pika 6 ndryshon me këtë përmbajtje:

“6. Dosja e personelit ka karakter konfidencial. Personat që kanë të drejtë të njihen me këtë dosje janë:

a) i punësuari, të cilit i përket dosja;

b) eprori direkt;

c) nëpunësit e njësisë së burimeve njerëzore që përgjigjen për mbajtjen dhe sistemin e tyre;

ç) titullari i institucionit;

d) Sekretari i Përgjithshëm;

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta”, Nd. 35, H. 1, Njesia Administrative N. 2, Tirana, Shqipëri
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300
www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- dh) Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil;
e) Departamenti i Administratës Publike; si dhe
ë) institucione të tjera të ngarkuara nga ligji.”.

17. Në nenin 27, pika 1 shfuqizohet.

18. Në nenin 29, pika 5 ndryshon me këtë përmbajtje:

“5. Sektori i Burimeve Njerëzore përgatit një Raport mbi realizimin e trajnimeve brenda muajit janar të vitit pasardhës”.

19. Pas nenit 30 shtohet neni 30/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 30/1 – Trajnimet afatgjata jashtë vendit

1. Nëpunësit civilë të INSTAT-it mund të zhvillojnë trajnime fakultative afatgjata jashtë vendit, në zbatim të marrëveshjeve përkatëse të nënshkruara ndërmjet INSTAT-it dhe institucioneve ofruese të këtyre trajnimeve.

2. Trajnimi afatgjatë jashtë vendit përfshin periudhën deri në 6 (gjashtë) muaj dhe është me shkëputje nga puna. Gjatë periudhës së trajnimit deri në 6 (gjashtë) muaj, nëpunësi merr pagën e plotë, përjashtuar shtesat për vështirësi dhe kushte pune.

3. Në mbarim të këtyre trajnimeve, nëpunësi duhet të rikthehet të punojë në vendin e mëparshëm, por jo më pak se pesë vjet. Kur nëpunësi refuzon të kthehet në vendin e mëparshëm, ai duhet të dëmshpërblejë institucionin për shpenzimet e kualifikimit.

4. Në trajnimet afatgjata përfshihen edhe praktikantët (traineeships) e ofruara në kuadër të programeve të BE-së IPA jo më shumë se 6 (gjashtë) mujore që nëpunësit e INSTAT-it zhvillojnë pranë Eurostatit dhe/ose autoriteteve të tjera statistikore. Në këtë rast, ndërmjet INSTAT-it dhe nëpunësit të përzgjedhur për kryerjen e praktikës nënshkruhet një marrëveshje sipas të cilës INSTAT-i garanton ruajtjen e vendit të punës dhe pagesën gjatë kryerjes së praktikës, ndërkohë që nëpunësi garanton rikthimin në vendin e punës dhe qëndrimin për jo më pak se tre vjet. Në rast se nëpunësi refuzon rikthimin ose vendos të largohet nga INSTAT-i gjatë periudhës tre-vjeçare, atëherë nëpunësi detyrohet të dëmshpërblejë INSTAT-in në vlerën totale të pagave të dhëna gjatë periudhës së praktikës.”

20. Në nenin 31 të Kreut VI bëhen këto shtesa e ndryshime:

a) pika 8 ndryshon me këtë përmbajtje:

“8. Angazhimi i punonjësit në veprimtari të jashtme nuk duhet të jetë me kohë të plotë, pavarësisht natyrës së kësaj veprimtarie dhe procedura për marrjen e miratimit nga eprori të jetë në përputhje me VKM nr. 874, datë 29.09.2021 “Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta”, Nd. 35, H. 1, Njesia Administrative N. 2, Tirana, Shqipëri
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300
www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

b) në pikën 9, pas fjalëve “të rastit kur” shtohen fjalët “kjo ndalohet shprehimisht nga ligji dhe/ose”.

c) pas pikës 9 shtohet pika 10 me këtë përmbajtje:

“10. Në mungesë të një autorizimi, nëpunësi nuk duhet të dëshmojë si ekspert përpara ndonjë trupi gjyqësor apo të përfaqësojë ndonjë person fizik ose juridik, vendas apo të huaj, organizatë, entitet apo qeveri të huaj, nëse institucionet e administratës publike janë palë apo kanë ndonjë interes të drejtpërdrejtë dhe të rëndësishëm në çështjen që shqyrtohet.”

21. Në nenin 32 të Kreut VI, pika 3, pas fjalëve “oficerin për mbrojtjen e të dhënave” shtohen fjalët “Komitetin e Konfidencialitetit”.

22. Në nenin 34, pika 1, paragrafi (iii), numri “5” zëvendësohet me numrin “3”.

23. Në nenin 39 të Kreut VI bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) në fund të pikës 1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Kjo vlen dhe për dokumentet shoqëruese të shkresës (tabela ose materiale shkrimore).”

b) Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Dokumentet shoqëruese të shkresave që dalin nga institucioni (tabela ose materiale shkrimore) duhet të siglohen në çdo faqe nga nëpunësi që i ka hartuar dhe nga eprori i tij.”

24. Në nenin 42 të Kreut VII, pika 2, pas fjalëve “për dijeni (cc)” shtohet fjalia “përgjegjësi”.

25. Në nenin 43 të Kreut VII bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) pika 2 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“2. Punonjësit mund të qëndrojnë jashtë orarit zyrtar të punës në ambjentet e INSTAT-it, vetëm nëse titullari i institucionit miraton urdhrin përkatës për detyrën që duhet të kryhet, kohëzgjatjen e saj dhe të punësuarin apo të punësuarit që do të ngarkohet/n me kryerjen e kësaj detyre.”

b) fjalia e dytë e pikës 3 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“3. Nëse nevoja për të qëndruar jashtë orarit zyrtar lind për më pak se 2 ditë, atëherë lejen për të qëndruar jashtë orarit e jep Drejtori i Përgjithshëm/Sekretari i Përgjithshëm sipas kërkesës së drejtorit të drejtorisë së përgjithshme të varësisë.”

26. Në nenin 49 të Kreut VII, pika 3, fjalët “Brenda muajit Maj” të zëvendësohen me fjalët “Çdo vit”.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta”, Nd. 35, H. 1, Njesia Administrative N. 2, Tirana, Shqipëri
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300
www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

27. Në nenin 53 të Kreut IX, pika 1 ndryshon me këtë përmbajtje:

“1. Çdo nëpunës i INSTAT-it është përgjegjës për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve si dhe dokumentacionit kundrejt humbjeve, vjedhjeve, dëmtimeve apo keqpërdorimit të tyre dhe merr masat për përdorimin e tyre vetëm për qëllime zyrtare. Në rast të keqfunksionimit të mjeteve të inventarit dhe/ose të zyrës, duhet të njoftojë menjëherë eprorin e tij dhe njësinë e shërbimeve mbështetëse.”

28. Në nenin 54, pika 2, fjalia e parë shfuqizohet.

29. Në nenin 55 të Kreut X, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) pikat 2,3,4,5,6 ndryshohen me pikat 2,3,4,5,6 me përmbajtje respektivisht si më poshtë:

“2. Lëvizja e stafit jashtë qendrës së punës, por brenda vendit, kryhet si rregull me automjetet e INSTAT-it. Nëse nevojat e përlllogaritura për automjete i tejkalojnë kapacitetet eventualisht të disponueshme në institucion, lëvizja e punonjësve për në destinacionet e shërbimit mund të kryhet me mjetet e transportit publik. Institucioni bën trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, duke respektuar përcaktimet e parashikuara në kuadrin ligjor përkatës.

3. Drejtoria e Financës dhe Projekteve, përkatësisht Sektori i Shërbimeve përgatit kalendarin e e shërbimeve mujore në një format që përfshin aktivitetet specifike të shërbimeve që do të kryhen, punonjësit që do të angazhohen në shërbimet përkatëse, destinacionet, kohën, qëllimin e shërbimit dhe mjetet me të cilat do të kryhet, sipas të dhënave që jepen nga Sektori i Koordinimit dhe Mbledhjes së të Dhënave.

4. Sektori i Koordinimit dhe Mbledhjes së të Dhënave është përgjegjës sipas pikës 3 të këtij neni, për administrimin, konsolidimin dhe dërgimin brenda datës 25 të muajit paraardhës të informacioneve me kërkesat e drejtorive për shërbime jashtë institucionit, tek përgjegjësi i sektorit të shërbimeve, sipas një formati ku tregohen datat e parashikuara, qëllimi dhe destinacioni i shërbimit.

5. Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve harton përmbledhësen e udhëtimeve dhe, nëpërmjet eprorit direkt, dhe Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme ia paraqet për miratim Sekretarit të Përgjithshëm. Një udhëtim shërbimi nuk mund të bëhet pa u dhënë më parë pëlqimi paraprak nga Sekretari i Përgjithshëm.

6. Autorizimi i shërbimeve emergjente të udhëtimit, apo shërbimeve të tjera të pa trajtuara dhe të pa mbuluara me mjete transporti në planin e miratuar të shërbimeve mujore, mund të bëhet me kërkesë të argumentuar të Drejtorit të Drejtorisë të interesuar, tek Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse dhe Koordinimit, dhe miratim të Sekretarit të Përgjithshëm. ”

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta”, Nd. 35, H. 1, Njesia Administrative N. 2, Tirana, Shqipëri
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300
www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

b) pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1. Punonjësi i INSTAT që merr pjesë në një aktivitet, mbledhje apo takim pune, konferencë etj., jashtë vendit apo jashtë qytetit ku ndodhet qendra e tij e punës, informon me shkrim eprorin direkt, titullarin e institucionit dhe njësinë e burimeve njerëzore në rrugë protokollare.”

30. Në nenin 56 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) pika 6 ndryshon me këtë përmbajtje:

“6. Përpara zhvillimit të vizitave zyrtare dhe të punës jashtë shtetit, punonjësi i INSTAT merr miratimin paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm apo të personit të autorizuar prej tij e njofton ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme.”

b) pika 7 shfuqizohet.

31. Në nenin 62, pika 1, fjalia e parë ndryshon me këtë përmbajtje:

« Intraneti është një platformë moderne për informimin dhe komunikimin mes punonjësve për të rritur komunikimin e brendshëm. »

32. Në nenin 67 të Kreut XIII, fjala “tremujor” zëvendësohet kudo me fjalën “katërmujor”.

33. Në nenin 68, pika 3, fjalët “31 janar” të zëvendësohen me fjalët “28 shkurt”.

34. Në nenin 70, bëhen këto shtesa dhe ndryshime :

a) në pikën 1, fjalët “3 anëtarë” të zëvendësohen me fjalët “5 anëtarë” ;

b) në pikën fjalët “gjashtë muaj” të zëvendësohen me fjalën “vit”.

35. Aneksi 4 “Kërkesa për leje” zëvendësohet me Aneksin 4 “Kërkesa për leje” sipas formatit bashkëlidhur.

36. Aneksi 7 “Model - Skeda e trajnimit të punonjësit” shfuqizohet.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ELSA DHULI



INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta”, Nd. 35, H. 1, Njesia Administrative N. 2, Tirana, Shqipëri
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300
www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Aneksi 4. Model - Kërkesë për leje



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

DREJTORIA PËRGJITHSHME

DIREKTORIA

Tiranë më: ____/____/202__

MIRATOHET

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Për: DREJTORINË E FINANCËS DHE PROJEKTEVE

Subjekti: Kërkesë për kryerjen e pushimeve vjetore të paguara

Mbështetur në VKM Nr. 568, datë 6.10.2021 "Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore", kërkoj të kryej pushimet vjetore të paguara për vitin 20__, duke filluar nga data ____/____/20__ deri më datë ____/____/20__.

Kërkuesi

Konfirmuesi

(nëpunësi)

(eprori direkt)

Konfirmuesi

Konfirmuesi

Për përputhshmërinë me planifikimin e lejeve
(P. Sektorit të Burimeve Njerëzore)

(Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme)

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta", Nd. 35, H. 1, Njesia Administrative N.2, Tirana, Shqipëri,
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300
www.instat.gov.al / info@instat.gov.al

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta", Nd. 35, H. 1, Njesia Administrative N. 2, Tirana, Shqipëri
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300
www.instat.gov.al / info@instat.gov.al